



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:071099

Datë: 11.06.2019

Numri i dokumentit: 00351090

P. nr. 889/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.Q., K Gjakovë, për shkak të veprës penale sulm ndaj personave zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.1712/18 e datës 14.02.2018,në shqyrtimin fillestar , të mbajtur më datë **06.06.2019**, në prani të Prokurorit te shtetit Dëshire Jusaj dhe te akuzuarit F.Q. ,të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.Q.**, K Gjakova, data e lindjes... ne Gjakovë , i biri i H. dhe i nënës H. e gjinisë Z., ka të kryer shkollën e mesme ,hoteleri, i gjendjes se mesme ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar atë i 1 fëmije ,numer personal....

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me dt. 03.11.2018 rreth orës **10:00** min,në lagjen B. K Gjakovë , seriozisht e kanos policin F.F. ,gjersa i njëjti po ushtronte detyrën e tij zyrtare si polic pran Stacionit Policor Njësi i Trafikut ne Gjakovë , ashtu qe pasi fillimisht i pandehuri ishte ndaluar ne fshatin K. K Gjakovë , për shkak te tejkalimit te shpejtësisë ne zonën 40km/h ,dhe pasi te njëjti shqiptohet gjoba kundërvajtës, i revoltuar ofendon policët duke iu thanë “jeni njerëz te pashkollë dhe se nuk dini te kryeni detyrën e juaj dhe do te shihemi “dhe pasi vrullshëm ka lëviz nga aty ,ndalohet në lagjen B. nga policia e njëjtë ,ku refuzon te prezanton dokumentet dhe kanos policinë F. me fjalët se “ do te shihemi privatisht “ për çka arrestohet dhe dërgohet ne st. policor.

-me çka ka krye veprën penale sulm ndaj pësonit zyrtare gjatë kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1 te KPRK-ës .

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,49,50,51,73 të KPRK-ës, nenit 410/1 te KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari F.F.,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1712/18 e datës 14.02.2018, , e ka akuzuar të akuzuarin F.Q. K Gjakovë, për shkak të veprës penale sulm ndaj personave zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1 te KPRK-së,

Gjatë shqyrtimit fillestar, me të datës 06.06.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Dëshire Jusaj, lexon aktakuzën PP.nr.1712/18 e datës 14.02.2018 dhe, deklaroi se mbetet ne tersi pranë aktakuzës.

I akuzuari F. Q. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar për veprat e kryera në afekt , premtojë se një veprim e tillë nuk do te përsëritë dhe kërkojë falje nga i dëmtuari per veprimet e mija .Andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimi se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, do te jem me i kujdesshëm , si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Dëshire Jusaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari F.Q.: **-me dt. 03.11.2018** rreth orës **10:00** min,në lagjen B. K Gjakovë , seriozisht e kanos policin F.F.,gjersa i njëjti po ushtronte detyrën e tij zyrtare si polic pran Stacionit Policor Njësi i Trafikut ne Gjakovë , ashtu qe pasi fillimisht i pandehuri ishte ndaluar ne fshatin K.,K Gjakovë , për shkak te tejkalimit te shpejtësisë ne zonën 40km/h ,dhe pasi te njëjti shqiptohet gjoba kundërvajtës, i revoltuar ofendon policët duke iu thanë “jeni njerëz te pashkollë dhe se nuk dini te kryeni detyrën e juaj dhe do te shihemi “dhe pasi vullshëm ka lëviz nga aty ,ndalohet në lagjen B. nga policia e njëjtë ,ku refuzon te prezanton dokumentet dhe kanos policinë F.me fjalët se “ do te shihemi privatisht “ për çka arrestohet dhe dërgohet ne st. policor.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka

administruar provat ,gjkata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjkata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprave penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të veprës penale të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 1 fëmije, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, kërkim falja nga te dëmtuarit si dhe faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim unik me burgim në kohëzgjatja prej 4(**katër**) **muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.889/18 më datë 06.06.2019**

**Sekretarja juridike
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja
Ilijana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.